

# KISCOMS

INTERNATIONAL CONGRESS OF MEDICAL SCIENCES

6-7 May, 2017  
Swiss Diamond Hotel  
Prishtina, Republic of Kosovo

## ABSTRACT BOOK

F I N A L P R O G R A M

KISCOMS





## “Karcinoma e gjirit - përcjellja statistikore për periudhën 2006-2011 në Shkup”

Sh. Musa<sup>1</sup>, V. Dobrosavleviq<sup>1</sup>, P. Simjanoski<sup>1</sup>, R. Pejçinovska<sup>2</sup>, M. Gjetaj-Jakovski<sup>1</sup>, P. Malinska<sup>1</sup>, L. Kostadinovski<sup>1</sup>/ <sup>1</sup>Qendra për Shëndet Publik–Shkup, R. e Maqedonisë

**Hyrje:** Karcinoma e gjirit sipas OBSH zë vendin e dytë 10,9%, karcinoma e mushkërive (12,7%). Në vitin 2008 janë diagnostifikuar 1,38 milion raste të reja (23% nga të gjitha karcinomat).

**Qëllimi:** Të prezantohet morbiditeti nga karcinoma e gjirit në rajonin e Shkupit, pacienta që kanë kërkuar trajtim në institucionet për mbrojtje shëndetësore të femrave.

**Materiali dhe metoda:** Metoda statistikore e punës. Analiza gjashtëvjeçare e morbiditetit e vërtetuar sipas KNS-10 Revizion. Janë përpunuar bazat e të dhënave kompjuterike të raporteve: 3-00-60; 3-05-60; 3-21-61A. Janë përpunuar bazat e të dhënave nga 2160 raporte nga ordinancat e mjekësisë së përgjithshme, 360 nga ordinancat gjinekologjike për mbrojtje primare shëndetësore dhe 8576 raporte nga trajtimi stacionar për pacienta të



hospitalizuar në rajonin e Shkupit.

**Rezultate:** Në periudhën gjashtëvjeçare në rajonin e Shkupit neoplazmat (C00–D48) marrin pjesë me 1,5% nga vizitat e regjistruara në ordinancat e mjekësisë së përgjithshme ku 23,5% janë me karcinom të gjirit. 96,6% prej pacientëve janë të gjinisë femërore. (58,1%) me karcinomë të gjirit janë me moshë prej 45-64 vite. Në ordinancat gjinekologjike dhe akusherj të nivelit primar, janë të regjistruara 7,5% neoplazma ku 2,8% janë me karcinomë të gjirit. Komunitetet urbane udhëheqin me karcinomë të gjirit në krahasim me komunitetet rurale. Në spitale prej numrit të përgjithshëm të neoplazmave 15,1% janë me karcinomë të gjirit. Për 13,3% karcinomat e gjirit janë më të larta në vitin 2011 krahas vitit 2006, që ndjek trendin e neoplazmave prej 12,8% në vitin 2011 krahas vitit 2006. Pacientët e prekur janë të gjinisë femërore ose 95,6% janë femra. Sipas strukturës së moshës 43,1% janë me moshë prej 51-64 vite. Sa i përket lokalizimit sipas KNS-10 Revizion, më të shpeshtë janë pacientët me diagnozën C50.4 (kuadranti i sipërm i jashtëm i gjirit), por ai regjistrohet dhe në të gjithë lokalizimet të tjera (C50.0-C50.9). Sipas rezultateve histopatologjike më të përfaqësuar janë karcinomat intraduktale në kuadrantin e lateral të majtë të gjirit.

**Përfundim:** Vizitat e pacientëve me karcinomë të gjirit në vitin 2011 janë trefishuar krahas me vitin 2006. Në komunitetet urbane në Shkup pacientët me karcinomë të gjirit përfaqësohen me nivel të njëjtë, në komunitetet rurale ky numër është dukshëm më i vogël dhe preket popullata e moshuar.

**Fjalë kyçe:** Karcinomë, mjekësi e përgjithshme, spitalet, morbiditeti, statistika.

**“Statistical review of breast carcinoma in Skopje for the period 2006-2011”**

Sh. Musa<sup>1</sup>, V. Dobrosavljevik<sup>1</sup>, P. Simjanoski<sup>1</sup>, R. Pejcinovska<sup>2</sup>, M. Gjetaj – Jakovski<sup>1</sup>, P. Malinska<sup>1</sup> Lj. Kostadinovski<sup>1</sup>/ <sup>1</sup>Center for Public Health – Skopje, R. Macedonia

**Introduction:** According to the WHO, breast carcinoma is positioned second with 10.9% and lung carcinoma with 12.7%. In 2008 were diagnosed 1.38 million new cases (23% of all carcinomas).



**Goal:** The purpose is to present the acknowledged morbidity from breast carcinoma in the Skopje region of patients who requested treatment at the health care institutions for women at all levels of the health system.

**Materials and methods:** Statistical method of operation. Six-year analysis of acknowledged morbidity according to ICD 10 Revision. Computer databases of reports were processed: 3-00-60; 3-05-60; 3-21-61A. Processed databases were from 2160 reports from general medicine practice, 360 gynecology practices in primary health care and 8576 reports for stationary person treated for hospitalized patients in the Skopje region.

**Results:** In the analyzed period of six years on the territory of Skopje, Neoplasms (C00-D48) participated with 1.5% of registered visits to practices of general medicine or 23.5% with breast carcinoma. 96.6% of patients were female. In the practices of general medicine more than half patients (58.1%) were with breast carcinoma, aged 45-64 years. In the gynecology practices and obstetrics on primary level registered with 7.5% of neoplasms or from them 2.8% with breast carcinoma. The number breast carcinoma patients is higher in urban municipalities compared to rural municipalities. In hospitals from the total number of neoplasms, breast carcinoma accounts for 15.1%. Breast carcinoma is by 13.3% higher in 2011 compared to 2006 and follows the trend of neoplasms of 12.8% in 2011 compared to 2006. 95.6% from the patients were women. In terms of age structure 43.1% were aged 51-64 years. In terms of localization according to ICD-10 Revision most common are with the diagnosis C50.4 (upper outer quadrant of the breast), but this is registered in all other localizations (C50.0-C50.9). According to histopathological findings the most common are intraductal carcinoma in the left lateral quadrant of the breast.

**Conclusions:** In 2011 visits of patients with breast carcinoma are three times higher compared to 2006. In urban municipalities in Skopje visits of patients with breast carcinoma reflect the same level, while in rural areas the number is significantly lower with the highest proportion of senior citizens.